



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/37  
Datë: 24.10.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe Ligjin Nr. 05/L-009, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 tetor 2020, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Shkarkohet Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve i Ndërmarrjes Publike Qendrore "Korporata Elektroenergjetike e Kosovës - KEK" Sh. A.
2. Ky vendim shfuqizon Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 04/19 të datës 03.08.2020.
3. Emërohet Bordi i Përkohshëm i N. P. "Korporata Elektroenergjetike e Kosovës - KEK" Sh. A. në këtë përbërje:
  - 3.1. Z. Musa Misini - Kryesues, Drejtor;
  - 3.2. Z. Petrit Ibraj - Drejtor;
  - 3.3. Znj. Fatime Grajcevci - Drejtoreshë;
  - 3.4. Z. Fadil Hoxha - Drejtor.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Avdullah HOTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë